

KONTRATA SOCIALE DURRËS

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2022-SHTATOR 2023

Viti i IV i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Centre” në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- “Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës;
- “Qendra Rinore”, Vlorë;
- Qendra “Epoka e Re”, Fier;
- Qendra “Intelektualët e Rinj Shpresë”, Shkodër;
- “Lëvizja Rinore për Demokraci”, Pukë;
- “Qendra Rinore për Progres”, Kukës;
- Qendra “Tjetër Vizion”, Elbasan;
- Qendra “Gruaja në Zhvillim”, Korçë;
- Qendra “Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës.

Ky Raport është Përgatitur nga “Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës në kuadër të projektit POP “Përballja e Ofertave Politike”, “Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy”. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	4
FALENDERIME	4
HYRJE	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
METODOLOGJIA	7
KONTRATA SOCIALE E BASHKISË DURRËS	8
PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE	11
REKOMANDIME PËR BASHKINË DURRËS	14
ANEKSE	15

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	13 prioritetet kryesore të identifikuara nga komuniteti gjatë 2019

Falenderime

Me mirënjohje falenderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore në përmbushjen e prioritetëve të Kontratës Sociale.

Falenderojmë Bashkinë Durrës, si edhe Këshillin Bashkiak Durrës, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë periudhës Shtator 2022 - Shtator 2023.

Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit POP-Përballja e Ofertave Politike, të cilët po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve, ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2022 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "POP 2022 - Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca" në 12 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër, Korçë, Vau i Dejës, Elbasan. Përgjatë vitit 2023 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Ky është raporti i katërt monitorues, i përgatitur nga "Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile – Durrës".

Për të hartuar "Kontratën Sociale të Bashkisë Durrës", CSDC Durrës ka zhvilluar në muajve tetor-dhjetor 2021, janar-shkurt dhe shtator 2022, 20 fokus grupe me banorë të lagjeve të qytetit Durrësit, Katundit të Ri, Manzës, Rrashbullit dhe Sukthit. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioritetëve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej fokus grupeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Nga focus grupet dolën gjerësisht 7 çështje prioritare të cilat më pas u sintetizuan në një dokument edhe më specifik atë të prioritetëve të shkurtuara të firmosur nga kandidatet për kryetare bashkie z. Ardian Muka, Partia e Lirisë, z. Luan Hoti, Partia Demokratike dhe znj. Emiriana Sako, Partia Socialiste për zgjedhjet e pjesshme të 6 Marsit 2022 për Bashkinë Durrës.

Gjatë vitit 2023 projekti vijon me "Kontrata Sociale 2023: Forcimi i Angazhimit të Qytetarëve në Qeverisjen Vendorë." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llobojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër, Korçë, Vau i Dejës, Elbasan, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Gjatë muajve Shtator 2022 - Shtator 2023 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet.

Përmbledhje Ekzekutive

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe të përçojë te qytetarët informacionin në lidhje me vendimmarrjen lokale si të orientojë politikbërjen dhe vendimmarrjen lokale drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre.

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e POP për Qeverisjen në Bashkinë Durrës në periudhën shtator 2022 - shtator 2023 dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit së shërbimeve të ofruara në nivel vendor për përmbushjen e 7 prioriteteve të Kontratës Sociale, vlerësimin e këshilltarëve dhe stafit të bashkisë në lidhjen me demokracinë vendore, si dhe gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Në Bashkinë Durrës POP u realizua nga Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësim të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Gjatë kësaj periudhe në zbatimin e POP komuniteti i Bashkisë Durrës, shërbeu si njësi bazë analize për nxitjen e llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë publike të institucionit të bashkisë. Ai mundësoi monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, ndërkohë që ofroi mundësi që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumenta dhe strategji, të tilla si: Strategjia e Zhvillimit të Territorit Bashkisë Durrës, buxheti i bashkisë për vitin 2022-2023, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Ligji 139/2015 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Vetëqeverisjes Vendore”, faqja e internetit e Bashkisë Durrës, Plani përfshirjes sociale për bashkinë Durrës; Vendimet e Këshillit Bashkiak, etj

Bashkia Durrës ka punuar në përmbushje të angazhimeve të Kontratës Sociale dhe për disa nga prioritetet vërehet ecuri e mirë në realizimin e tyre dhe po kështu ka nevojë për fokus në realizimin e të tjerave.

Në këtë raport do të lexoni: 1) Metodologjinë e projektit; 2) Kontrata Sociale e Bashkisë Durrës; 3) Përmbledhjen e rezultave të vlerësimit të qytetarëve Durrsakë për qeverisjen vendore në zbatim të Kartës Sociale; 4) dhe 5) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.

Metodologjia

POP ka vendosur në qendër të këtij raportimi vetë qytetarët/komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendimarrëse vendore. POP po zbatohet në një nivel shumë të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i tij ndikon në zhvillimin e qeverisjes me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se POP nuk duhet kuptuar vetëm si një proces vlerësimi, pasi nëpërmjet tij ndërtohen mënyra e mjete ndërveprimi mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

Përfituesit e këtij procesi janë komuniteti dhe autoritet vendore. Procesi i mundëson komunitetit të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe efikasitetin e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve të bashkisë; të shprehë opinionin e tij dhe t'u kërkojë atyre përmirësimet e nevojshme. Nga ana tjetër POP i jep mundësinë autoriteteve vendore të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritetet të komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Në Bashkinë Durrës procesi u realizua nëpërmjet disa etapave, të tilla si: (I) vlerësim e monitorim i buxhetit të Bashkisë Durrës dhe Vendimeve të Këshillit Bashkiak; (II) vlerësimi komunitar për Kontratën Sociale (4 fokus grupe me qytetare të Bashkisë Durrës në zonën urbane dhe rurale); (III) vlerësimi i dokumentacioneve apo raporteve të tjera bazuar në punën e

rrjetit POP apo të organizatave të tjera (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte); (IV) Monitorimi i vendimeve të qeverisë në lidhje me përmbushjen e ndonjë prej prioriteteve me buxhet ndihmë për pushtetin vendor, si p.sh mbështetje për ngritje të shkollave, qendrave shëndetësore apo të tjera të kategorive të ngjashme. (V) Monitorim i mediave në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike. dhe (VI) përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesit, advokimin dhe monitorimin.

Kontrata Sociale e Bashkisë Durrës

Për të hartuar "Kontratën Sociale të Bashkisë Durrës", CSDC Durrës ka zhvilluar në muajve tetor-dhjetor 2021, janar-shkurt dhe shtator 2022, 14 fokus grupe me banorë të lagjeve të qytetit Durrësit, Katundit të Ri, Manzës, Rrashbullit dhe Sukthit. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej fokus grupeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Nga fokus grupet dolën gjerësisht 7 çështje prioritare të cilat më pas u sintetizuan në një dokument edhe më specifik atë të prioriteteve të shkurtuara të firmosur nga kandidatet për kryetare bashkie z. Ardian Muka, Partia e Lirisë, z. Luan Hoti, Partia Demokratike dhe znj. Emiriana Sako, Partia Socialiste për zgjedhjet e pjesshme të 6 Marsit 2022 për Bashkinë Durrës.

Në vazhdimësi të monitorimit të Kontratës Sociale 2022-2023, CSDC Durrës ka realizuar 4 fokus grupe dhe takime me zyrtarë të Bashkisë për të parë ecurinë e plotësimit të tyre, si dhe monitorimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Në njërën prej tyre, datë 30.06.2023, nisur nga strategjitë e ndërmarra në nivel qëndror, ajo e decentralizimit ku një ndër objektivat e saj është dhe transformimi digjital, Znj. Miriam Recic theksoi rëndësinë se si Bashkitë duhet të marrin masa për të siguruar objektivat e kësaj strategjie, në veçanti atë të transformimit digjital. Për sa më sipër ajo sugjeroi se do të ishte me vend për tu marrë në shqyrtim nga këshilli bashkiak Durrës, për ngritjen e një komisioni cili të mbulonte këtë çështje, pra një komision mbi transformimin digjital apo sido që mund të emërtohet duke u parë ligjërisht, mbase dhe i përkohshëm si komision. Kjo për arsye të ndjekjes dhe zbatimit të objektivave. Nisur nga ky sygjërim më 13.07.2023, u mor vendimi që pjesë e komisioneve të ishte dhe *Komisioni i Teknologjisë dhe Inovacionit*.

Përmbledhje e rezultateve

Gjetjet nga fokus grupet:

Siç u shpjegua më sipër në raport, në proces u përfshinë qytetarët në Durrës dhe në njësitë administrative. Paralelisht me ta u intervistuan edhe këshilltarët bashkiakë dhe punonjësit e bashkisë. Më poshtë parqesim një përmbledhje të rezultateve e dala dhe analizuara nga ky vlerësim. Në forume pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht 7 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Shërbimet publike;
2. Zhvillimi ekonomik vendor;
3. Dimensioi social dhe
4. Demokracia vendore

Prioriteti 1: Riorganizim i mekanizmave që sigurojnë shkëmbim reciprok të informacionit dhe transparencën e mbledhjeve dhe vendimeve që merr Këshilli Bashkiak për qytetarët e Bashkisë Durrës.

- Institucioni është transparent dhe korrekt në publikimin e informacioneve të përditësuara dhe marrjes së vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- Një pjesë e madhe e qytetarëve nuk kanë informacion që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura;
- Qytetarët shprehen se i janë drejtuar zyrës së informacionit pranë Bashkisë, kanë dërguar letër me protokoll, por nuk kanë marrë përgjigje, konkretisht në Njësinë Administrative Sukth, për ccështjen mbeturinave;
- Në Njësinë Administrative Katund i Ri, fshati Kullë, kryeplaku i fshatit nuk ka zyrë dhe pjesa më e madhe e banorëve nuk kanë patur mundësinë ta takojnë ndonjëherë.

Prioritet 2: Shtimi i koshave të mbetjeve dhe plotësimi aty ku nuk ka (Spitallë, Kullë, Sukth etj.) për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga mbledhja e makinës së mbeturinave të paktën një herë në dy ditë në të 11 (njëmbëdhjetë) Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

- Konkretisht në zonën e Spitallës, fshatin Kullë dhe Borç, mbetet problem numri i koshave të mbeturinave, të cilët janë të pamjaftueshëm nëpër lagje dhe në raport me popullsinë e zonës;
- Në zonat e mësipërme, banorët raportojnë që banuës të tjerë të zones i zhvendosin koshat sipas interesit të tyre për t'i patur më afër, duke ua bërë të vështirë të tjerëve për shkak të largësisë;

- Në Njësitë Administrative raportohet që mbledhja e mbeturinave kryhet në intervale jo të rregullta.

Prioritet 3: Përmirësimi në sistemin e kanalizimeve (ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në Njësitë Administrative Manëz, Katund i Ri, Rashbull dhe Sukth). Vijimin e përmirësimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe sinjalistikën në: Njësia Administrative Shkozet: Rr. Aleksandër Goga; Stacionin e Trenit - Ura e Dajlanit; Njësia Administrative Manëz: Fshatrat Kamerras, Kucok; Njësia Administrative Katundi i ri: Rashbull; Njësia Administrative Sukth.

- Për përmirësimin e sistemit të kanaleve kulluese dhe vaditëse në Njësinë Administrative Sukth, në fshatin Kullë nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Në fshatin Kullë shpesh për shkak të bllokimit të tyre, gjatë rreshjeve të shiut krijohet përmytje;
- Në Njësinë Administrative Sukth mungon sistemi i kanalizimeve, duke sjellë përmytje gjatë rreshjeve.
- Banorët shprehen se në zonën e ish-kënetës është një kanal i hapur, punimet për të cilin janë ndërprerë përkohësisht, si dhe për shkak të mosmirëmbajtjes së tyre, ndodhin përmytje të shpeshta, si në zonën e ish-kënetës apo lagjen 18.

Prioritet 4: Shtimi dhe sistemimi i hapësirave të gjelbërta që shërbejnë si hapësira pushimi dhe argëtimi për të gjitha grupmoshat në të gjitha Njësitë Administrative, duke planifikuar disa në një vit kalendarik.

- Nga raportimet e qytetarëve, rezulton që as në qytetin e Durrësit dhe as në ndonjë prej Njësive Administrative nuk është realizuar diçka e tillë, megjithëse është e nevojshme dhe për mjedisin, dhe për qytetarët, sidomos në disa zona si ajo e Spitallës apo Kullës, ku kryesisht grupmosha e fëmijëve nuk kanë hapësira argëtimi;
- Nuk ka zona pushimi apo argëtimi që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga ë gjithë qytetarët.

Prioritet 5: Përmirësimi i cilësisë së transportit publik duke i kërkuar operatorëve: Përcaktimin dhe publikimin e orareve të transportit publik; Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion; Përmirësim i kushteve higjeno-sanitare; Rritja e shpeshtësisë së autobusëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17:00 në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

- Qytetarët raportojnë moskorrektësi në orare dhe shpeshtësi të ulët të mjeteve të transportit urban;
- Në stacionet ekzistuese nuk ka orare të afishuara, ndërsa në Njësitë Administrative nuk ka stacione në vendqëndrimin e autobusave dhe rrjedhimisht as orare të afishuara, përveç atyre në xhamat e mjeteve.
- Banorët e Njesisë Administrative Sukth shprehen se do të ishte ndihmuese për ta të kishte linjë Sukth-Durrës dhe Sukth-Manëz, pasi autobusët e Hamallaj dhe Manzës kalojnë, por janë të mbushur kur arrijnë në Sukth.

Prioritet 6: Të transferohet Biblioteka Publike Durrës në mjedise të posaçme për këtë institucion mjaft të rëndësishëm, duke u konsultuar me shoqërinë civile, publikun dhe akademikët e Bashkisë Durrës.

- Biblioteka Publike Durrës vazhdon të jetë në të njëjtën godinë, e cila nuk plotëson kushtet për të qenë një mjedis i denjë për këtë institucion;
- Bashkia Durrës ka prezantuar një plan projekt ku bën pjesë dhe ndryshimi i vendndodhjes së bibliotekës nga vendndodhja aktuale, në ambjentet e bibliotekës ekzistuese, e cila do të ndahet në dy pjesë, në Muzeut e Dëshmorëve.

Prioritet 7: Të alokohet buxhet specifik në buxhetin e vitit 2023 të Bashkisë Durrës, për Këshillin Vendor Rinor dhe për mbështetje financiare të nismave rinore.

- Deri më tani nuk ka patur një buxhet specifik për Këshillin Vendor Rinor Durrës apo për nismat rinore në përgjithësi;
- Kryetarja e Bashkisë Durrës, znj. Emiriana Sako u shpreh që për të alokuar një buxhet specifik për Këshillin Vendor Rinor, duhet paraqitur një plan aktivitetesh nga ana e tyre që më pas të justifikohet në buxhet.

Gjetje nga takime me zyrtarë të Bashkisë Durrës:

Prioriteti 1: Riorganizim i mekanizmave që sigurojnë shkëmbim reciprok të informacionit dhe transparencën e mbledhjeve dhe vendimeve që merr Këshilli Bashkiak për qytetarët e Bashkisë Durrës.

Nga gjetjet rezulton që institucioni është transparent dhe korrekt në publikimin e informacioneve të përditësuara dhe marrjes së vendimeve të Këshillit Bashkiak. Faqja e web është relativisht e përditësuar me informacionet e fundit dhe përbërjen e strukturës së Bashkisë.

Prioritet 2: Shtimi i koshave të mbetjeve dhe plotësimi aty ku nuk ka (Spitallë, Kullë, Sukth etj.) për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga mbledhja e makinës së mbeturinave të paktën një herë në dy ditë në të 11 (njëmbëdhjetë) Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

Sipas raportimit të zyrtarëve të Bashkisë Durrës, ka rritje të flotës së pastrimit nga ana e Bashkisë Durrës në zonat më kryesore dhe të populluara të qytetit.

Prioritet 3: Përmirësimi në sistemin e kanalizimeve (ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në Njësitë Administrative Manëz, Katund i Ri, Rashbull dhe Sukth). Vijimin e përmirësimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe sinjalistikën në: Njësia

Administrative Shkozet: Rr. Aleksandër Goga; Stacionin e Trenit - Ura e Dajlanit; Njësia Administrative Manëz: Fshatrat Kamerras, Kucok; Njësia Administrative Katundi i ri: Rrashbull; Njësia Administrative Sukth.

Sipas raportimeve nga ana e zyrtarëve të Bashkisë Durrës, ka një plan projekt me financin nga qeveria për të ndërhyrë në të gjitha kanalizimet. Në momentin që do të miratohet fondi, do të fillojë dhe zbatimi i projektit.

Prioritet 4: Shtimi dhe sistemimi i hapësirave të gjelbërta që shërbejnë si hapësira pushimi dhe argëtimi për të gjitha grupmoshat në të gjitha Njësitë Administrative, duke planifikuar disa në një vit kalendarik.

Sistemimi i hapësirave për pushim dhe argëtim do të bëhet brenda shesheve në blloqet pallateve, si në rastin e parkut “Vala e re” në lagjen 18, Durrës. Për momentin nuk ka plan-projekte të tjera konkrete.

Prioritet 5: Përmirësimi i cilësisë së transportit publik duke i kërkuar operatorëve: Përcaktimin dhe publikimin e orareve të transportit publik; Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion; Përmirësim i kushteve higjieno-sanitare; Rritja e shpeshtësisë së autobuzëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17:00 në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

Zyrtarët raportojnë që kjo është përgjegjësi e operatorëve të linjave të transportit public dhe për raportin e monitorimit nga ana e Bashkisë Durrës ndaj operatorëve, mund t’i drejtohet një kërkesë për informacion drejtorisë përkatëse pranë Bashkisë.

Prioritet 6: Të transferohet Biblioteka Publike Durrës në mjedise të posaçme për këtë institucion mjaft të rëndësishëm, duke u konsultuar me shoqërinë civile, publikun dhe akademikët e Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës ka prezantuar një plan projekt ku bën pjesë dhe ndryshimi i vendndodhjes së bibliotekës nga vendndodhja aktuale, në ambientet e bibliotekës ekzistuese, e cila do të ndahet në dy pjesë, në Muzeut e Dëshmorëve.

Prioritet 7: Të alokohet buxhet specifik në buxhetin e vitit 2023 të Bashkisë Durrës, për Këshillin Vendor Rinor dhe për mbështetje financiare të nismave rinore.

Kryetarja e Bashkisë Durrës, znj. Emiriana Sako u shpreh që për të alokuar një buxhet specifik për Këshillin Vendor Rinor, duhet paraqitur një plan aktivitetesh nga ana e tyre që më pas të justifikohet në buxhet.

Gjetje të tjera:

- Ka një shtrirje të shërbimeve sociale në Njësitë Administrative, siç është Qendra Komunitare Rrashbull dhe qendrat e reja të themeluara në Durrës (Qendra e Reziliencës). Në kuadër të kësaj të fundit, ka filluar shërbimi social lëvizës, nëpërmjet të cilit identifikohen rastet dhe më pas gjindet mundësia për të dhënë shërbimin e nevojshëm.

- Nga plani i rindërtimit dhe rikonstruktimit të objekteve arsimore pas tërmetit, janë rindërtuar/rikonstruktuar 37 objekte, 20 prej të cilave janë të përfunduara dhe 17 në proces.

Rekomandime për Bashkinë Durrës

- Të lehtësohet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe institucionit të Bashkisë Durrës, duke formuluar një strategji dhe për moshta e treta që nuk mund të aksesojnë faqen e ëeb apo rrjetet sociale.
- Të shtohen koshat e mbeturinave në Njësitë Administrative dhe fshatrat përreth.
- Të bëhen plane për ndërhyrje konkrete në kanalizime, kryesisht në Njësitë Administrative. Problemi i permbytjeve nga kanalizimet ka shkaktuar shqetësim tek komuniteti. Është e nevojshme të vazhdojmë punën për përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve për të minimalizuar rrezikun e permbytjeve në të ardhmen.
- Të monitorohen nga ana e Bashkisë kontratat me kompanitë e transportit publik, duke siguruar korrektësi në zbatim dhe transparencë për qytetarët.
- Të ofrohet transport publik në Njësitë Administrative dhe fshatrat përreth, si fshati Borç dhe Kullë.

Aneks 1 Kontrata Sociale

Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor

- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për ato që lidhen ngushtësisht me interesat e qytetarëve dhe ndikimin e jetës së tyre, si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj.
- Faqe interneti lehtësisht e aksesueshme, e përditësuar me të gjitha informacionet e nevojshme.
- Vendosja e disa këndeve informuese (info points) të digjitalizuara në pika strategjike të qytetit, me qëllim informimin e qytetarëve, kryesisht vizitorëve vendas dhe të huaj.
- Fuqizimi i mekanizmave komunitarë të përfaqësimit:
 - o Këshilli Vendor i Rinisë dhe ndikimi i tij në politikat vendore për të rinjtë. Fuqizimi i Këshillave vendorë lokalë si mekanizma konsultues dhe monitorues të politikave rinore.
 - o Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.
- Ofrimi i shërbimeve online paralelisht me shërbimet tradicionale të sportelit, për të siguruar që të gjithë anëtarët e komunitetit të kenë akses në shërbimet e nevojshme, pavarësisht nga mosha apo statusi i tyre ekonomik.
- Publikimi i njoftimeve për mbledhjet e Këshillit Bashkiak, të paktën 10 ditë përpara mbledhjes, në përputhje me kuadrin ligjor, për rritjen e transparencës dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse.

Prioriteti 2. Drejtësia Sociale

- Ndërtimi i qendrave ditore për personat me aftësi të kufizuar dhe për moshën e tretë në Njësitë Administrative, pasi ato ekzistuese në qytetin e Durrësit janë shumë larg dhe të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e komunitetit.
- Ngritja e shërbimeve rehabilituese afatgjata për gratë, vajzat dhe fëmijët e mbijetuar të dhunës në familje, të cilat ofrojnë jo vetëm strehim të përkohshëm, por edhe programe rehabilitimi gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.
- Ngritja e shërbimeve sociale të lëvizshme, me staf që mund të punojë në terren dhe të monitorojë rregullisht mirëqenien e individëve vulnerabël, veçanërisht të të moshuarve që jetojnë vetëm.

Prioriteti 3. Rivitalizimi i Bibliotekës Publike

- Zhvendosja e Bibliotekës Publike të Durrësit në një vend më të përshtatshëm dhe të aksesueshëm për qytetarët.
- Krijimi i bibliotekave më të vogla në Njësitë Administrative, për të përmirësuar aksesin dhe për të ofruar burime informacioni më të mira për komunitetin, veçanërisht për të rinjtë.

Prioriteti 4. Hapësira publike për të rinjtë dhe grupmoshat e tjera.

- Krijimi i hapësirave të pushimit dhe argëtimit për banorët e të gjitha moshave, me fokus promovimin e aktiviteteve të lira dhe të sigurta për të rinjtë, si në Durrës-Qendër ashtu edhe në Njësitë Administrative.

Prioriteti 5. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Durrësit.

- Shpeshësia e lëvizjes së autobusëve të jetë sipas intervaleve kohore të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.
- Të ketë vendqëndrime me sinjalistikat përkatëse aty ku mungojnë, si p.sh.: Njësia Administrative Sukth, linja e Universitetit "Aleksandër Moisiu".
- Afishimi i orareve në vendqëndrimet e autobusëve, në Durrës-Qendër dhe në të gjitha Njësitë Administrative.
- Kohëzgjatja e orarit për lëvizjet e autobusëve edhe pas orës 17:00 për Njësitë Administrative.

Prioriteti 6. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Zhvillimi i programeve të dedikuara, që synojnë promovimin e krijimit të bizneseve të reja, me fokus të veçantë në fuqizimin e grave dhe të rinjve.
- Konsiderimi për krijimin e lehtësirave fiskale, që synojnë veçanërisht bizneset e krijuara nga gratë dhe të rinjtë.

Prioriteti 7. Shkollat, kopshtet dhe çerdhet

- Funksionimi i sistemit të ngrohjes në disa shkolla pas rindërtimit/rikonstruksionit të tyre, si shkolla 9-vjeçare dhe e mesme artistike "Jan Kukuzeli" dhe shkolla 9-vjeçare "Bajram Curri".
- Ngritja e kopshteve dhe çerdheve në Njësitë Administrative Sukth dhe Rashbull, pasi objektet ekzistuese shkollore nuk ofrojnë infrastrukturë të përshtatshme dhe ndodhen shumë larg për të akomoduar të gjithë fëmijët e zonës.

Prioriteti 8. Infrastruktura rrugore

- Shtrimi dhe rehabilitimi i rrugëve kryesore (Lagjja nr.7; Lagjja nr. 8; Xhafzotaj-Rrashbull).
- Shtrimi dhe rehabilitimi i rrugëve dytësore (Lagjja nr. 5; Lagje nr. 7; Lagjja nr. 13, fshati Kullë, Njësia Administrative Sukth).
- Rregullimi i trotuareve dhe përmirësimi i sinjalistikës (Rrashbull-Xhafzotaj).
- Vendosja e ndriçimit në rrugët dytësore (Lagjja nr. 13; Rashbull-Xhafzotaj).

Prioriteti 9. Pastrimi dhe mirëmbajtja

- Shtimi i numrit të koshave të mbeturinave dhe i shpeshësisë së mbledhjes së tyre (Njësia Administrative Sukth dhe Rashbull).
- Pastrimi dhe dezinfektimi në mënyrë të rregull i kazanëve të mbetjeve në Durrës-Qendër

dhe në të gjitha njësitë administrative.

- Vendosja e koshave të posaçëm për mbetjet e peshkut në zona si: rruga "Taulantia", për të trajtuar ndotjen e shkaktuar nga mbetjet e restoranteve gjatë stinës së verës.

Prioriteti 10. Garantimi dhe aksesimi në ujë të pijshëm dhe të konsumueshëm

- Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm për banorët e Njësisë Administrative Sukth.
- Adresimi i problemit të përmytjeve të shkaktuara nga bllokimet në kanalizimet e ujërave të zeza. Bashkia duhet të prioritetizojë ndërhyrjet, që synojnë përmirësimin e sistemit të kanalizimit në Njësitë Administrative Sukth dhe Rrashbull.

Aneks 2

Fokus grup, Qendra e Formimit Profesional Durrës (06/03/2023)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=716190097085060&set=pcb.716201083750628>
(498 reach, 116 engagements, 27 likes, 0 comment, 1 share)

Fokus grup me gazetarët (11/03/2023)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=720207390016664&set=pcb.720211990016204>
(381 reach, 95 engagements, 28 likes, 0 comment, 0 share)

Fokus grup NJA Rrashbull (15/03/2023)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=727175659319837&set=pcb.727179445986125>
(397 reach, 99 engagement, 14 likes, 0 comment, 2 shares)

Dalje në media DurrësLajm (22/04/2023)

<https://durrësLajm.al/a-do-te-kete-nje-perballje-publike-mes-kandidateve-sako-dhe-cara-ne-durres-video/>

Forum publik me z. Igli Cara, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" (26/04/2023)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=755394419831294&set=pcb.755394659831270>
(895 reach, 275 engagements, 30 likes, 0 comments, 4 shares)

Forum publik me znj. Emiriana Sako, Partia Socialiste (02/05/2023)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=758186192885450&set=pcb.758186926218710>
(253 reach, 272 engagements, 28 likes, 1 comments, 4 shares)

Takim me përfaqësues të Bashkisë Durrës

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=887772536593481&set=pcb.887772756593459>
(97 engagement, 21 likes, 0 comments, 0 shares)

Dëgjesa publike NJA Durrës 30/10/2023

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=885643053473096&set=pcb.885643110139757>

(60 engagement, 20 likes, 0 comments, 1 share)

Fokus grup NJA Sukth dhe Katund I Ri

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=878257304211671&set=pcb.878257517544983>

(133 engagement, 33 likes, 0 comments, 1 share)

Mbledhja e Këshillit Bashkiak 18/10/2023

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=877362814301120&set=a.534270745276997>

(30 engagement, 19 likes, 0 comments, 0 share)

Dëgjesa Publike për PBA NJA Sukth dhe Katund I Ri 17/10/2023

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=876584941045574&set=pcb.876585224378879>

(90 engagement, 27 likes, 0 comments, 1 share)

Mbledhja e Këshillit Bashkiak 28/09/2023

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=862916182412450&set=a.534270745276997>

(27 engagement, 14 likes, 1 comment, 0 shares)

Mbledhje e Këshillit Bashkiak 11/09/2023

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=850463423657726&set=pcb.850463476991054>

(75 engagement, 15 likes, 0 comments, 1 share)

Aneks 3

Gjetje nga raporti i parë i monitorimit Gusht 2019 – Gusht 2020

Publikimi i vendimeve dhe dokumentacioneve të tjera: Qytetarët e Durrësit e vlerësojnë shumë të rëndësishme transparencën në vendimmarrje. Edhe pse me disa përmirësime të vogla faqja e internetit e bashkisë përditësohet rrallë, ndërkohë që në këtë faqe qytetarët nuk gjejnë informacion të nevojshëm për ta dhe detyrohen të shkojnë deri në Bashki apo zyrat e ADISA për të marrë informacionin, që u nevojitet. Po kështu në njësitë administrative duhet më shumë vëmendje për këndet e shpalljeve të vendimeve apo njoftimeve. Në njësitë administrative Manëz dhe Sukth nuk ka as kënd për shpalljen e vendimeve apo njoftimeve publike.

Informimi dhe Komunikimi: Bashkia ka të ndërtuar një sistem për ta bërë informacionin dhe shërbimet të aksesueshme për qytetarët. Zyra e informacionit të Bashkisë dhe ADISA asistojnë

qytetarët në këtë proces. Vazhdon të mbetet shqetësim aksesimi i informacionit në NJA. Po kështu një tjetër problematikë e identifikuar në forumin e lagjeve të qytetit Durrës lidhet me personat me aftësi të kufizuar që sipas tyre janë të limituar nga marrja e informacionit. Nga ana tjetër qytetarët ndajnë dhe shqetësimin e komunikimit ndërmjet zyrave brenda bashkisë Durrës, nëse një shqetësim i ngritur nga ata kërkon bashkëpunim midis zyrave. Regjistri elektronik nuk përdoret asnjëherë e pjesa tjetër që lajmërimet individuale dhe njoftimet në gazetën lokale përdoren ndonjëherë.

Pjesëmarrja Në Vendimarrje: Nga diskutimet mbi këtë çështje në takimet e zhvilluara me qytetarët dhe stafin e bashkisë Durrës, konkludohet se Bashkia Durrës ndërmerr procese konsultimi me komunitetin për vendimarrjet më të rëndësishme, porse mekanizmi që përdor për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në to nuk është jo vetëm i unifikuar, por as edhe tërësisht efektiv. Stafit i Bashkisë Durrës shfaq konfuzion kur pyetet për strukturën përgjegjëse organizimin e BP-së, të cilat variojnë nga titullari i institucionit dhe deri tek organizatat e shoqërisë civile. Disa prej të intervistuarve mendojnë që struktura përgjegjëse është Drejtoria e Zhvillim Koordinimit dhe të tjerë e mendojnë si përgjegjësi të tre drejtorive së bashku: asaj të Zhvillim Koordinimit, Financave/Buxhetit dhe GMS.

Duket se monitorimi dhe vlerësimi i proceseve vijon të mbetet sfidë për bashkitë në vend. Edhe në Bashkinë Durrës nuk ka një sistem. Vërehet sërish konfuzion midis procesit BP dhe atij të Buxhetit Afatmesëm të bashkisë, i cili është parë me prioritet me hyrjen në fuqi të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore.

Qytetarët dhe Punonjësit e Bashkisë Durrës vlerësojnë si sfidë pjesëmarrjen e ulët të grupeve të interesit, grave, të rinjve, komuniteteve të marxhinalizuara, e sidomos në zonat rurale. Anëtarët e KB shprehin se ka nevojë për përmirësimin e proceseve të konsultimit, theksohet ndjeshëm rritja e bashkëpunimit Bashki-Këshill Bashkiak-komunitet, por edhe bashkëpunimi mes forcave politike në këshill, rritja e kapaciteteve si të anëtarëve të këshillit por edhe të stafit të bashkisë.

Ndër nevojat e tjera që ata listojë si të rëndësishme mund të përmendim:
Rritje e gjithëpërfshirjes qytetare në procese të konsultimit publik, e sidomos aktivizim nga shoqëria civile;
Rritje të transparencës dhe mirëorganizim të procesit të BP.

Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave: Si një nga funksionet e specifikuar edhe në ligjin për vetëqeverisjen vendore, ky prioritet mbetet kryesor në bashkinë Durrës. Një nga mënyrat e specifikuar në ligj është dhe mbështetja me grante për bizneset e vogla, gjë e cila nuk zbatohet në bashkinë Durrës. Po kështu miratimi i incentivave fiskale, ulja e tarifave vendore për bizneset që hapen nga të rinjtë dhe gratë është një procedure e cila duhet zhvilluar në Bashkinë Durrës.

Nxitja e punësimit: Qytetarët shprehën nevojën për të patur më shumë informacion nga Bashkia mbi përpjekjet që bën për të nxitur punësimin, ndërkohë që theksojnë se grate kryefamiljare, familjet në vështirësi ekonomike dhe të rinjtë, si ata të ardhur rishtazi në Durrës, ashtu edhe nga banorët ekzistues duhet të konsiderohen si grupe prioritare për punësim.

Gjelbërimi: Gjelbërimi, ambientet shlodhëse për të moshuarit dhe ambientet e lojës për fëmijët sidomos nëkushtet e krijuara edhe nga COVID, ku dalja në natyrë është shumë e rëndësishme, u cilësuanshëmë prioritare nga pjesëmarrësit në Forume. Për fëmijët dhe të moshuarit, problematika mëe madhe është mos pasja e hapësirave të gjelbërta dhe argëtuese, shlodhëse për ta. Mungesa e parqeve për fëmijët i detyron prindërit t'i çojnë fëmijët në qendra tregtare të qytetit për t'i argëtuar. Lulishtet e vogla edhe në sheshet e pallateve të qytetit konsiderohen emergjente.

Kanalet kulluese/vaditëse: Në të gjitha takimet e zhvilluara në Manëz, Katund të Ri, Rrashbull dhe Sukth u theksua se cilësia e kanaleve kulluese dhe vaditëse lë shumë për të dëshiruar. Kanalet kulluese në përgjithësi nuk janë funksionale duke shkaktuar kështu edhe përmbytje të herëpashershme. Në Manëz, vazhdon të mbetet problem mos pastrimi i kanaleve ekzistuese të kullimit, por edhe mungesa e kanaleve të kullimit në fshatra. Kanali në fshatin Shkallë, edhe pse me ndërhyrje të vogla mbetet problematik, ndërjryra në të do të zgjidhte këtë shqetësim për një zonë shumë të madhe. Pothuaj e njëjta situatë paraqitet edhe në NJA-të e tjera.

Infrastrukturë, rrugë dhe trotuare: Infrastruktura rrugore dhe trotuaret mbeten problematike në disa zona. Në Durrës vazhdon të mbetet problem ndërhyrja në zonën e Spitalit të Durrësit. Po kështu kërkohet monitorim e supervizim më i mirë në rastet që për ndërhyrje të ndryshme rrugët hapen dhe në përfundim të ndërhyrjeve të tyre, ato nuk risistemohen tërësisht. Gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuareve, dhe sinjalistika rrugore mbetet problem për banorët e lagjes 14 (lagje në kryqëzim të Urës së Dajlanit dhe zonës për në Stacionin e Trenit), ku ka mungesë semaforësh dhe vijash të bardha. Në Manëz u theksua nevoja për rregullimin e dy rrugëve në fshatin Kamerras, të rrugëve Beqallarët, Rrugës së Varrezave, sistemimi i Kucokut me rrugë dhe hapësira të gjelbërta, rrugës së Borçës e cila është me çakull, kur në fakt duhet të jetë me asfalt sipas standardeve. Në disa zona Bashkia Durrës ka bërë një punë të mirë në rrugët lidhëse me NJA-të por duhet vazhduar me ndërhyrje në rrugët e fshatrave dhe në rrugët bujqësore, në Sukth e Rrashbull.

Ndriçimi: Shqetësim për qytetarët përbën ndriçimi në zonat larg qendrës së qytetit. Bashkia ka realizuar disa ndërhyrje në segmente të vogla por puna duhet të vazhdojë sidomos në periferi ku në disa zona mungojnë shtyllat. Ndriçimi u konsiderua shumë i rëndësishëm edhe për sigurinë e qytetarëve, sidomos nga gratë dhe vajzat.

Pastrimi: Në thelb, qyteti i Durrësit pastrohet çdo ditë, theksuan pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të Durrësit, por ka nevojë për të shtuar numrin e koshave për mbetjet urbane. Koshat

egzistues janë të vjetër, me rrota të prishura dhe pa kapak. Ndërhyrje e menjëherëshme kërkohet në zonën arkeologjike dhe muzeale të Bashkisë Durrës, që ka vetëm 3 kosha për një zonë me mbi 500 banorë. Në forumin e Manzës u theksua se pastrimi bëhet nga vetë banorët. Mbeturinat lihen në rrugët kryesore, makina e pastrimit merrato që janë në rrugën kryesore dhe jo në të gjitha rrugët. Mungesa e koshave për grumbullimin e mbetjeve u theksua edhe në Katudin e Ri. Mungesa e tyre nxit banorët që ti hedhin mbetjet në lum e për rrjedhojë shpesh përjetojnë përmbytjen e lumit Erzen dhe dëmtim të tokave bujqësore. Numri i vogël i koshave të mbetjeve dhe distanca e madhe e atyre, që janë na vendbanimet u theksua në forumin e Sukthit. Të dyja këto ndikojnë që banorët t'i hedhin mbetjet vend e pa vend apo t'i derdhin në kanale që më pas nuk pastrohen.

Shkollat: Qyetarët vlerësuan ndërhyrjet e përvitëshme që ka kryer Bashkia për reabilitimin e shkollave si në qendër edhe në zonat periferike, megjithatë ka nevoja të vazhdueshme për infrastrukturën brenda shkollave egzistuese. Këto përfshijnë kryesisht sisteme ngrohje, terrene sportive dhe laboratorë të informatikës. Në forumet e Sukthit dhe Rrashbullit u theksua se shkollat egzistuese janë të amortizuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. Përveç infrastrukturës së papërshtatëshme të shkollave, pjesëmarrësit në forumin e Katundit të Ri theksuan edhe mungesën e personelit ndihmës në shkolla, kryesisht personel për pastrimin, ruajtjen e shkollës, sikurse dhe mungesën e psikologut. Shkollat nuk janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vlen të theksojmë edhe punën e bërë për reabilitimin e shkollave të dëmtuara nga tërmeti.

Kopshte dhe çerdhe: Në takime u theksua nevoja për përmirësime në infrastrukturën e kopshteve dhe çerdheve. Sa më shumë i largohemi qendrës së Bashkisë, aq më shumë shtohet nevoja për përmirësimin e kushteve. Gjithashtu u kërkua vëmendje edhe për ndërtimin e çerdheve të reja.

Transporti publik: Mungesa e transportit të qëndrueshëm dhe me orare të caktuara u konsiderua një problem nga pjesëmarrësit e forumit në Manzëz e që kërkon një zgjidhje. Shumë prej banorëve të kësaj njësie administrative i drejtohen Bashkisë për të marrë shërbime, ndërkohë që mungesa e shpeshtësisë në orare të autobuzëve krijon humbje kohe të panevojshme për ta. Tjetër problem është edhe kufizimi i orareve të autobuzëve deri në orën 17.00. Banorët shpesh detyrohen të përdorin taksit që krijon kosto për ta. Banorët kërkojnë që përveç shtimit të linjave, duhet të merret parasysh edhe ulja e çmimit të biletës së transportit pasi është shumë e kushtueshme për familjet të cilat janë edhe me ndihmë ekonomike. Në Forumet e Rrashbullit dhe Sukthit prioritar për zgjidhje u konsiderua çështja e transportit të fëmijëve për në shkolla për shkak të distancës së largët nga vendbanimi.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet: Rregullimi i infrastrukturës së ujërave të bardha dhe atyre të zeza në lagjet e qytetit të Durrësit është një tjetër prioritet i dalë nga forumet e zhvilluara në këtë territor. Në Manzëz, pjesëmarrësit në fokus grup theksuan se furnizimi me ujë të pijshëm

është i kufizuar në kohë, një herë në 48 orë dhe koha e furnizimit është vetëm 20 min në ditë. Ndërkohë ka familje që nuk furnizohen me ujë pasi nuk janë të lidhura me tubacionin e ujit. Në Njësinë Administrative Manëz, Fshati Manëz, mungon personeli për monitorimin e furnizimit me ujë të pijshëm të këtij fshati dhe fshatrave përreth. Aktualisht janë 5 depozita uji pa roje. Në njësinë administrative Rrashbull fashtarat Vrin dhe Shenvlash kanë 20 vjet pa ujë të pijshëm, ndërsa nuk ka problem në fshatrat e tjerë. Kufizimet në ujin e pijshëm u prezantuan si shqetësim për banorët e njësisë administrative në Sukth, ndërkohë që forumi në Katundin e Ri nuk evidentoi probleme me ujin e pijshëm pasi banorët përdorin pusët.

Aneks 4

Gjetje nga raporti i dytë i monitorimit Shtator 2020 – Shtator 2021

Publikimi i vendimeve dhe dokumentacioneve të tjera: Qytetarët e Durrësit e vlerësojnë shumë të rëndësishme transparencën në vendimmarrje. Në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe transparencën nga ana e Bashkisë, pjesa më e madhe e qytetarëve u shprehën se kishte mungesë informacioni dhe indiferencë nga ana e Bashkisë. Sipas tyre, informacionin në lidhje me thirrjet për dëgjesa publike, mund ta merrnin vetëm tek zyrat e informacionit pranë Bashkisë ose nëpërmjet OJF, nuk publikohen në faqen zyrtare. Edhe ato informacione të cilat publikohen, kanë një terminologji të papërshtatshme për publikun e thjeshtë, nuk është e kuptueshme. Nga ana tjetër kishte dhe individë, të cilët shprehen se mosinformimi është dhe përgjegjësi e vetë qytetarit, jo vetëm detyrë e Bashkisë. Në përfundim të diskutimit të kësaj pike, 70% prej qytetarëve mendonin se nuk është plotësuar fare, ndërsa 30% mendonin që pjesërisht. Po kështu në njësitë administrative duhet më shumë vëmendje për këndet e shpalljeve të vendimeve apo njoftimeve. Në njësitë administrative Manëz dhe Sukth nuk ka as kënd për shpalljen e vendimeve apo njoftimeve publike.

Informimi dhe Komunikimi: Bashkia ka të ndërtuar një sistem për ta bërë informacionin dhe shërbimet të aksesueshme për qytetarët. Sipas banorëve të lagjes Spitalle citojnë se bashkia nuk ka marrë ndonjë masë për shkëmbimin e informacionit apo transparencën e vendimeve për komunitetin, përveçse tek zyrat e informacionit në Bashki dhe në ëbsite e saj, edhe aty nuk janë të publikuara të gjitha dhe është e paaksesueshme për moshat e treta. Sipas qytetarëve të Njesisë Administrative Manëz citojnë se: Gjithashtu dhe për problematika që janë ngritur dhe adresuar në zyrën e informacionit nuk është marrë një përgjigje, si p.sh.: afati i përfundimit të shkollës që po rindërtohet në Kullë, pasi ka kaluar ai i pasqyruar në fletën e projektit. Në fshatin Borç nuk kanë një zyrë apo përfaqësi nga Bashkia, ku mund të drejtohen për problematikat e tyre apo informacione. Disa shprehen që Bashkia ka treguar indiferencë dhe në rastet kur problematikat janë adresuar, duke mos kthyer përgjigje për shqetësimet e ngritura.

Pjesëmarrja Në Vendimarrje: Duket se monitorimi dhe vlerësimi i proceseve vijon të mbetet sfidë për bashkitë në vend. Edhe në Bashkinë Durrës nuk ka një sistem. Vërehet sërish konfuzion midis procesit BP dhe atij të Buxhetit Afatmesëm të bashkisë, i cili është parë me prioritet me hyrjen në fuqi të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore. Qytetarët dhe Punonjësit e Bashkisë Durrës vlerësojnë si sfidë pjesëmarrjen e ulët të grupeve të interesit, grave, të rinjve, komuniteteve të marxhinalizuara, e sidomos në zonat rurale.

Gjelbërimi: Mungesa e parqeve për fëmijët i detyron prindërit t'i çojnë fëmijët në qendra tregtare të qytetit për t'i argëtuar. Lulishtet e vogla edhe në sheshet e pallateve të qytetit konsiderohen emergjente. Për sa u përket hapësirave të gjelbërta, sipas tyre nuk ka mjaftueshëm.

Kanalet kulluese/vaditëse: Në të gjitha takimet e zhvilluara në Manëz, Katund të Ri, Rrashbull dhe Sukth u theksua se cilësia e kanaleve kulluese dhe vaditëse lë shumë për të dëshiruar. Kanalet kulluese në përgjithësi nuk janë funksionale duke shkaktuar kështu edhe përmbytje të herëpashershme. Në Manëz, vazhdon të mbetet problem mos pastrimi i kanaleve ekzistuese të kullimit, por edhe mungesa e kanaleve të kullimit në fshatra. Kanali në fshatin Shkallë, edhe pse me ndërhyrje të vogla mbetet problematik, ndërhyrja në të do të zgjidhte këtë shqetësim për një zonë shumë të madhe. Pothuaj e njëjta situatë paraqitet edhe në NJA-të e tjera.

Infrastrukturë, rrugë dhe trotuare: Infrastruktura rrugore dhe trotuaret mbeten problematike në disa zona. Në Durrës vazhdon të mbetet problem ndërhyrja në zonën e Spitalit të Durrësit. Po kështu kërkohet monitorim e supervizim më i mire në rastet që për ndërhyrje të ndryshme rrugët hapen dhe në përfundim të ndërhyrjeve të tyre, ato nuk risistemohen tërësisht. Gjerësia dhe përshtatshmëria e trotuareve, dhe sinjalistika rrugore mbetet problem për banorët e lagjes 14. Në disa zona Bashkia Durrës ka bërë një punë të mirë në rrugët lidhëse me NJA-të por duhet vazhduar me ndërhyrje në rrugët e fshatrave dhe në rrugët bujqësore, në Sukth e Rrashbull.

Ndriçimi: Shqetësim për qytetarët përbën ndriçimi në zonat larg qendrës së qytetit. Bashkia ka realizuar disa ndërhyrje në segmente të vogla por puna duhet të vazhdojë sidomos në periferi ku në disa zona mungojnë shtyllat. Ndriçimi u konsiderua shumë i rëndësishëm edhe për sigurinë e qytetarëve, sidomos nga gratë dhe vajzat.

Pastrimi: Në thelb, qyteti i Durrësit pastrohet çdo ditë, theksuan pjesëmarrësit në Forumet e lagjeve të Durrësit, por ka nevojë për të shtuar numrin e koshave për mbetjet urbane. Koshat egzistues janë të vjetër, me rrota të prishura dhe pa kapak. Ndërhyrje e menjëherëshme kërkohet në zonën arkeologjike dhe muzeale të Bashkisë Durrës, që ka vetëm 3 kosha për një zonë me mbi 500 banorë. Në forumin e Manëzës u theksua se pastrimi bëhet nga vetë banorët. Mbeturinat lihen në rrugët kryesore, makina e pastrimit merrato që janë në rrugën kryesore dhe jo në të gjitha rrugët. Numri i vogël i koshave të mbetjeve dhe distanca e madhe e atyre,

që janë na vendbanimet u theksua në forumin e Sukthit. Të dyja këto ndikojnë që banorët t'i hedhin mbetjet vend e pa vend apo t'i derdhin në kanale që më pas nuk pastrohen.

Transporti publik: Në lidhje me transportin publik, shqetësimi i parë që u shpreh ishte për linjën e universitetit. Gjatë stinës së verës, kur studentëve u duhej të shkonin në ambjentet e universitetit për regjistrime apo riprovime, nuk kishte autobuza. Përgjatë vitit akademik ishte problem shpeshtësia ose numri i autobuzëve, urbane mbushej plot që në dy stacionet e para dhe nuk ndalonte në stacionet e tjera, duke bërë që studentët të shkonin në leksione me vonesë ose të bënin rrugë në këmbë deri tek stacionet e para.

Gjithashtu dhe linja Durrës-Plepa kishte pak a shumë të njëjtën problematikë, ndalonte në stacionet përkatëse, por kishte raste që dhe jo, për shkak të numrit shumë të madh të pasagjerëve. Tabela për oraret nuk ka në asnjë stacion të asnjë linje. Autobuzi i universitetit nuk ka tabelë treguese për stacion autobuzi në çdo stacion. As në zonën e Shijakut. Pjesa më e madhe e studentëve u duhej të merrnin nga dy urbane çdo herë që shkojnë në leksion, prandaj propozuan që të shihej mundësia e një aboneje për studentët, e cila të jetë e përdorshme për çdo linjë. Gjithashtu dhe shtimi i numrit të autobuzëve në oraret e mëngjesit.

Transporti publik nuk është i aksesueshëm për PAK. Nuk ka një vend të veçantë, ku të ulen. Nuk ka rampa. Një prind shprehet që u detyrua të blinte makinë, pasi transporti publik nuk është praktik për përdorim të përditshëm me fëmijën e saj. Prindërit sugjerojnë që të ketë abone apo librezë që të mbulojë të paktën shpenzimet e biletave të fëmijëve.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet: Rregullimi i infrastrukturës së ujërave të bardha dhe atyre të zeza në lagjet e qytetit të Durrësit është një tjetër prioritet i dalë nga forumet e zhvilluara në këtë territor. Furnizimi me ujë nuk ishte i shpeshtë, p.sh. në Lagjen Guza, vinte vetëm në mëngjes, 3 orë dhe më pas nuk kishte gjatë gjithë ditës; në Lagjen e Mesme, Sukth, vinte një ditë po, një ditë jo. Nuk ka kanalizime në zonë. Kanalizimet për ujërat e zeza janë të improvizuara nga vetë familjet pranë banesave të tyre.

Aneks 5

Gjetje nga raporti i tretë i monitorimit Shtator 2021 – Shtator 2022

Prioriteti 1: Riorganizim i mekanizmave që sigurojnë shkëmbim reciprok të informacionit dhe transparencën e mbledhjeve dhe vendimeve që merr Këshilli Bashkiak për qytetarët e Bashkisë

Durrës.

- Institucioni është transparent dhe korrekt në publikimin e informacioneve të përditësuar dhe marrjes së vendimeve të Këshillit Bashkiak;

- Mbetet problematike aksesueshmëria nga çdo grupmoshë dhe terminologjia e përdorur në disa fusha, si p.sh. ajo e buxhetit, nuk është e kuptueshme për publikun e gjerë.
- Në raste kërkesash apo adresimi problematikash, qytetarët nuk dinë ku të drejtohen apo çfarë alternative tjetër kanë përveç zyrave të informacionit në godinën e Bashkisë, e cila nuk është lehtë e aksesueshme nga banorët e Njësive Administrative. Kjo përfshihet në pikën e parë, për shkak se vjen nga mungesa e informacionit, që është deri diku përgjegjësi e përfaqësuesve të Njësive Administrative, të cilët janë të ndërvarur nga Bashkia.

Prioritet 2: Shtimi i koshave të mbetjeve dhe plotësimi aty ku nuk ka (Spitallë, Kullë, Sukth etj.) për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga mbledhja e makinës së mbeturinave të paktën një herë në dy ditë në të 11 (njëmbëdhjetë) Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

- Konkretisht në zonën e Spitallës, fshatin Kullë dhe Borç, mbetet problem numri i koshave të mbeturinave, të cilët janë të pamjaftueshëm nëpër lagje dhe në raport me popullsinë e zonës;
- Përveçse gjatë sezonit të verës, kur mbledhja e mbeturinave bëhet 2-3 herë në ditë në qendër Durrës, në Njësitë Administrative raportohet që mbledhja e tyre kryhet në intervale jo të rregullta.

Prioritet 3: Përmirësimi në sistemin e kanalizimeve (ndërrhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në Njësitë Administrative Manëz, Katund i Ri, Rashbull dhe Sukth). Vijimin e përmirësimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe sinjalistikën në: Njësia Administrative Shkozë: Rr. Aleksandër Goga; Stacionin e Trenit - Ura e Dajlanit; Njësia Administrative Manëz: Fshatrat Kamerras, Kucok; Njësia Administrative Katundi i ri: Rashbull; Njësia Administrative Sukth.

- Për përmirësimin e sistemit të kanaleve kulluese dhe vaditëse në Njësinë Administrative Sukth, në fshatin Kullë dhe as në zonën e Spitallës, nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Në fshatin Kullë shpesh për shkak të bllokimit të tyre, gjatë rreshjeve të shiut krijohet përmytje;
- Kanalet e ujërave të zeza, kryesisht në zonën e Spitallës, janë të zbuluara, duke shtuar dhe nivelin e ndotjes;
- Rrugët dytësore janë të pashtruara, referuar zonave të përmendura më sipër, duke iu mbivendosur problematikës së përmytjes, duke e bërë të vështirë lëvizjen e banorëve në periudha të caktuara.

Prioritet 4: Shtimi dhe sistemimi i hapësirave të gjelbërta që shërbejnë si hapësira pushimi dhe argëtimi për të gjitha grupmoshat në të gjitha Njësitë Administrative, duke planifikuar disa në një vit kalendarik.

- Nga raportimet e qytetarëve, rezulton që as në qytetin e Durrësit dhe as në ndonjë prej Njësite Administrative nuk është realizuar diçka e tillë, megjithëse është e nevojshme dhe për mjedisin, dhe për qytetarët, sidomos në disa zona si ajo e Spitalës apo Kullës, ku kryesisht grupmosha e fëmijëve nuk kanë hapësira argëtimi.

Prioritet 5: Përmirësimi i cilësisë së transportit publik duke i kërkuar operatorëve: Përcaktimin

dhe publikimin e orareve të transportit publik; Korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion; Përmirësim i kushteve higjieno-sanitare; Rritja e shpeshtësisë së autobuzëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17:00 në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës.

- Bashkia Durrës e ka të publikuar në faqen e saj zyrtare tabelën me itineraret dhe shpeshtësinë e autobuzave, por nuk ka asnjë raport monitorimi nga ana e saj;
- Qytetarët raportojnë moskorrektësi në orare dhe shpeshtësi të ulët të mjeteve të transportit urban;
- Në stacionet ekzistuese nuk ka orare të afishuara, ndërsa në Njësitë Administrative nuk ka stacione në vendqëndrimin e autobuzave dhe rrjedhimisht as orare të afishuara, përveç atyre në xhamat e mjeteve;
- Në krkesën për informacion drejtuar nga CSDC Durrës, lidhur me shqetësimet e mësipërme, Bashkia Durrës në përgjigjen e saj më datë 30.09.2022, është shprehur se “nga ana e institucionit do të merren masa për zgjidhjen e kësaj problematike, duke njoftuar Ndërmarrjen Rrugë (ndërmarrje në varësi të Bashkisë Durrës), për vendosjen e sinjalistikës”.

Prioritet 6: Të transferohet Biblioteka Publike Durrës në mjedise të posaçme për këtë institucion mjaft të rëndësishëm, duke u konsultuar me shoqërinë civile, publikun dhe akademikët e Bashkisë Durrës.

- Biblioteka Publike Durrës vazhdon të jetë në të njëjtën godinë, e cila nuk plotëson kushtet për të qenë një mjedis i denjë për këtë institucion;
- Nuk ka asnjë komunikim zyrtar nga Bashkia Durrës për transferimin e saj.

Prioritet 7: Të alokohet buxhet specifik në buxhetin e vitit 2023 të Bashkisë Durrës, për Këshillin Vendor Rinor dhe për mbështetje financiare të nismave rinore.

- Deri më tani nuk ka patur një buxhet specifik për Këshillin Vendor Rinor Durrës apo për nismat rinore në përgjithësi;
- Në buxhetin e vitit 2023 nuk është parashikuar një buxhet specifik për qëllimet e sipërpërmendura.